

Bujar DUGOLLI

Universitetit i Prishtinës dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Ishin vitet e '60 të shekullit të kaluar kur filloi së funksionuari arsimiti i lartë në Kosovë dhe pas një kohe relativisht të shpejtë u pa brumosja e rinisë me idetë patriotike dhe përparimtare. Viti 1968, shënon fillimin e demonstratave studentore dhe rinisë së Prishtinës ku ishte kërkuar themelimi i universitetit në gjuhën shqipe, dhe po ashtu, ishin kërkuar të drejta të barabarta të shqiptarëve në Jugosllavi. Kjo veprimtari ishte frymëzuar nga Ilegalja Shqiptare dhe ideologu i saj Adem Demaçi. Pushteti i asaj kohe, ishte përgjigjur me masa represive. Dy protestues ishin vrarë, me dhjetëra e me qindra ishin plagosur, burgosur dhe diferencuar. Klasa politike e cila ishte në pushtet në Kosovë, nuk i kishte përkrahur studentët dhe as mbështetur kërkesën e tyre për avancimin e statusit të vendit në “Republikë”. Përkundrazi! Strukturat politike i kishin konsideruar këto demonstrata si të jashtëligjshme dhe në kundërshtim me rendin kushtetues të Jugosllavisë.

Vetëm një vit pas demonstratave të njohura të vitit 1968, Kuvendi i atëhershëm i Kosovës, mori vendimin për themelimin e Universitetit të Prishtinës. Konsideroj se, Universiteti i Prishtinës u themelua si rezultat i kërkesave dhe presionit të rinisë së Kosovës të brezit '68. Regjimi në Beograd, nuk e kishte përkrahur asnjëherë zhvillimin dhe emancipimin e shqiptarëve dhe çdo gjë që u kishte lejuar e kishte bërë në mënyrë të detyrueshme dhe nën tryninin e vazhdueshme

të patriotëve shqiptarë, në masë të madhe studentëve!¹ Në kohën kur lindi UP-ja, gjendja e shqiptarëve në ish-Jugosllavi dominohej nga diskriminimi dhe terrori i Beogradit si qendër, por edhe nga diskriminimi dhe terrori i qendrave të tjera politike dhe administrative në ish-Federatën jugosllave, siç ishin: Shkupi, Podgorica etj. Por, shqiptarët, ishin populli i tretë për nga numri në ish-Jugosllavi dhe deri në vitet e '70 nuk gëzonin as edhe një status autonom të mirëfilltë politik.

Diskriminimi nacional, kulturor, gjuhësor, arsimor, terrori politik dhe ekonomik, shpërngulja e dhunshme për në Turqi, varfëria e madhe etj., e përbënin pasqyrën e tyre reale të gjendjes nën ish-Jugosllavi.

Shumë shpejt klasa e studentëve të këtij universiteti do të marr edhe një rol politik: do të ketë përherë një ndërlidhje me zhvillimet politike dhe do t'i ndikojë ato zhvillime, qoftë përmes individëve dhe grupeve të studentëve, deri edhe te format masovike, si Demonstratat e vitit 1981, të cilat u shndërruan në revolucion gjithëpopullor. Në këtë mënyrë, Universiteti bëri jetën e tij midis tempullit të dijes dhe revolucionit.

Kështu, si edhe në vitin 1968, studentët e Universitetit të Prishtinës u ngritën në protesta dhe në demonstrata masive në pranverë të vitit 1981. Ata, dolën rrugëve dhe shesheve dhe kërkuan të drejta të barabarta legjitime politike dhe ekonomike dhe padyshim, kërkuan nga Federata jugosllave t'ia njoh Kosovës, statusin e republikës.

Është e pakuptueshme se si klasa politike ose ajo që quhet “klasa komuniste e Kosovës”, as këtë herë nuk u rreshtua në anën e studentëve, dhe as nuk e përkrahën parullën e legjitimuar nga studentët,

¹ Në të ashtuquajturin “Libri i kaltër” (1977), periudha prej viti 1965 e këndej, konsiderohej si “humbje e Serbisë në paqe”.

nxënësit dhe punëtorët “Kosova Republikë”. Përkundrazi! Klasa politike shqiptare, dështoi edhe kësaj here që ta luaj rolin strategjik dhe historik për t’u rreshtuar në shërbim të popullit dhe të Kosovës. Zyrtari i vetëm që u rreshtua në anën e studentëve dhe popullit, ishte Ukshin Hoti, i cili drejtonte resorin për Marrëdhënie me jashtë të Krahinës së Kosovës. Përgjatë zhvillimit të këtyre ngjarjeve, regjimi federal në Beograd, dërgoi polici dhe tanke në Kosovë:⁹ studentë u vranë (versioni zyrtar), dhe me qindra e mijëra të tjerë u larguan nga universiteti, u diferencuan, u burgosën dhe u dënuan me vite të gjata burgimi.

Establishmenti politik në Prishtinë dhe në Beograd, i kualifikoi këto demonstrata si kundërrevolucionare. Apologjia e këtillë serbo-jugosllave, pavarësisht nga përkatësia politike e nacionale, akoma dhe sot i klasifikon Demonstratat e studentëve të vitit 1981 si të dyshimta, si kundërrevolucionare e madje, edhe me prapavijë antishqiptare, ashtu siç një dekadë e gjysmë më vonë tentoi ta klasifikonte kryengritjen çlirimtare në Kosovë.

Promovimi i gjuhës së urrejtjes, i gjuhës së dhunës e terrorit, pas këtyre ngjarjeve të njohura, ishte rikonsoliduar edhe si një platformë e gjerë politike dhe propagandistike serbo-jugosllave me qendër në Beograd.²

² “Promovimi i gjuhës së urrejtjes ndaj popullit shqiptar, kulturës dhe gjuhës shqipe në mjetet e informimit (NIN, 1985, Danas, 1986, 1987 etj.), disa botime publicistike (S. Gjakoviq, 1984, V. Milanoviq, 1990, Gj. Lekiq, 1993 etj.), madje edhe në disa vepra shkencore të krijuesve serbë (Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, 1986, D. Bogdanoviq, 1985, M. Grashanini, 1988, M. Macura, 1989 etj.) e përforconte mendimin dhe e shtynte këtë që të merrte formën e qëndrimit mbi përgatitjen e masave integrale shtetërore për zhdukjen e së kaluarës dhe së tashmes së popullit shqiptar të këtyre viseve duke mos lënë vend për ardhmërinë e tyre”.

Pavarësisht masave represive që u ekzekutuan pas ngjarjeve të vitit 1981, përpara këtij viti dhe pas tij, studentët e Universitetit të Prishtinës ishin pjesë edhe e lëvizjeve ilegale çlirimtare politike. Ata, pa u ndalur, formuan me dhjetëra e dhjetëra organizata politike duke i promovuar idetë e tyre patriotike, dhe duke e mbajtur të gjallë rezistencën nacionale për çlirim dhe bashkim kombëtar. Këto dhe faktet të tjera, demantojnë çdo përpjekje për ta minimizuar ose për ta përbaltur luftën tonë për të drejta kombëtare.

Edhe përgjatë viteve të '90, ishin studentët e Universitetit të Prishtinës (këtë radhë në bashkëpunim me profesorët e tyre), ata që u ngritën sërish në mënyrë masive në mbrojtje të të drejtave të popullit dhe Universitetit. Më e jashtëzakonshme se gjithçka tjetër, ishte mobilizimi i tyre për të mos e lënë që të shuhej ky institucion strategjik-educativ dhe arsimor, kuptohet, pas futjes së masave të dhunshme politike dhe administrative të Beogradit në Universitetin e Prishtinës.³

Në rrethanat e reja të krijuara në Kosovë dhe më gjerë, pas viteve të '90, Universiteti i Prishtinës nuk u gjunjëzua dhe, as nuk u mposht asnjëherë. Përkundrazi! Studentët, vazhduan të ishin në radhët e para të rezistencës në të gjitha aspektet. Ëndrra e heronjve studentë (Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Afrim Zhitia etj.), u konkretizua me amanetin e tyre, pikërisht në Universitetin e Prishtinës. Filozofinë e dijes dhe të lirisë, studentët e shfaqën edhe njëherë në vitin 1997, me vendosmëri e guxim kur ata, u organizuan ta demaskonin botërisht terrorin dhe okupimin serb të Kosovës.

(Stavileci, Esat, Nushi, Pajazit, Të vërteta për Kosovën, Lidhja Shqiptare në Botë, Prishtinë 2000, f. 83).

³ Kuvendi i Serbisë, Gazeta zyrtare e RS të Serbisë, nr. 13/1990, f. 429, 26.11.1990, Beograd.

Më 1 tetor 1997 në ngjarjen tashmë të njohur, studentët dhe profesorët e Universitetit të Prishtinës i than jo robërisë së mëtejme. Pas kësaj ngjarjeje, e cila shënon fillimin e rezistencës aktive e që u shndërrua më vonë edhe në rezistencë çlirimtare, studentët dhe Universiteti u afruan me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e cila tashmë vepronte në mënyrë aktive në pjesë të ndryshme në Kosovë. Të guximshëm e me plot vullnet e dashuri atdhetare, qindra e mijëra studentë u rreshtuan në radhët e UÇK-së.

Vetëm në luftën e fundit çlirimtare me armë në dorë, ranë dëshmorë 323 studentë të UP-së, ndërsa mbi 70% e dëshmorëve të luftës së fundit ishin studentë dhe të diplomuar nga ky institucion, me çka e dëshmon se lufta jonë çlirimtare e udhëhequr nga UÇK-ja, kishte një formësim politik dhe ideor.

Në fund, konstatoj se, Universiteti i Prishtinës ishte simbol dhe krenari nacionale e edukimit dhe e arsimimit të popullit tonë, por edhe fanar i ndriçimit të rrugës së vështirë të emancipimit dhe të ngritjes së vetëdijes politike për çlirim dhe bashkim.

Studentët dhe intelijenca e re e krijuar nga UP-ja, ka luajtur rol vendimtar në historinë e revolucionit të Kosovës. Kështu ka ndodhur gjatë gjithë gjysmës së dytë të shekullit XX, që është koha më historike e Kosovës. Edhe më parë ka ndodhur, në vende të tjera, që një klasë e studentëve të ketë ndikime të mëdha në proceset politike (të kujtojmë lëvizjen liberale të vitit 1968 nëpër Evropë), por që klasa e studentëve e dal dhe e formësuar nga Universiteti i Prishtinës në vitet 1968, 1981 dhe 1997, të ketë ndikimin themeltar në proceset politike për një gjysmë shekulli, të marrë rolin e nismëtarit dhe të prijatarit nëpër këto procese, kjo nuk ka ndodhur në asnjë vend tjetër të Evropës më fuqishëm se në Kosovë.

